

**VENDIM**  
**Nr. 158, datë 2.7.2021**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SHA, PËR LËNIEN PENG TË  
ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK  
ALBANIA SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”; nenit 44, pika “1”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6, nenit 7 dhe nenit 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të Licencës”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, nenit 53, pika 3 dhe neneve 91 dhe 92, të “Kodit të Procedurave Administrative”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.7.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 100/2 prot., datë 29.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘Elva 2001’ sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të bankës *Intesa Sanpaolo Bank Albania* sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a., me shkresën nr. 14 prot., datë 20.6.2021, depozituar në ERE, më datë 22.6.2021, protokolluar me tonën nr. 767 prot., ka kërkuar miratimin për lënien peng të aseteve të paluajtshme, në favor të *Intesa Sanpaolo Bank Albania* sh.a., për efekt të livrimit të një kredie për ndërtimin e HEC “Mivas”, si dhe për mbulimin e pagesave të furnitorëve.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendim të Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.

- Në mbledhjen e Bordit, të datës 2.7.2021, u relatua relacioni nr. 100/2, datë 29.06.202, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Elva 2001’ sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme, në favor të *Intesa Sanpaolo Bank Albania* sh.a.”.

- Për këtë kërkesë, u vlerësua shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për fillimin ose jo të kësaj procedure, duke qenë se lindi nevoja për sqarime rreth dokumentacionit të këtij aplikimi si vijon:

- Vendimet e Asamblesë të depozituara në ERE, në të cilat listohen asetet që kërkohen të hipotekohen/barrësohen, në të cilat referohen dy kontrata kredie. Për këtë, shoqëria duhet të sqarojë nënshkrimin e dy kontratave kredie në të njëjtën datë.

- Gjithashtu duhet bërë me dije nëse shoqëria është në rrethanat e një riskstrukturimi të një kredie të marrë më herët. Nëse jemi në rrethanat e një ristrukturimi duhet bërë me dije cilat janë arsyet që kanë çuar në këtë ristrukturim.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen/t e hipotekimit/barrësimit, si dhe listën e aseteve me vlerat respektive, pasi në zbatim të legjislacionit në fuqi, ERE shprehet vetëm për asetet e paluajtshme, që prekin veprimtarinë e licencuar, vlera e të cilave kalon 150.000.000 lekë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës së shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të *Intesa Sanpaolo Bank Albania* sh.a., deri në 30 ditë pune.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**